Co-funded by the European Union
Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Agency for Development and Cooperation SDC
Sweden Sverige
Norwegian Embassy

Platforma CiviKos me mbështetje të DEMOS kanë formuar **grupin e Auditimit Social në Kamenicë.**

| | |
|---|---|
| Projekti | **Shpërndarja e Ujit për Fshatrat Hogosht dhe Lisockë në Komunën e Kamenicës** |
| Çmimi total i punëve në kontratë | **EUR 321,184.17** |
| Statusi i kontratës | **I përfunduar** |

Grupi i Auditimit Social ka 18 anëtarë.




## GJETJET KRYESORE



Ka mungesë të informatave nga përfaqësuesit e Komunës për organizimin e procesit të konsultimit publik për projektin në fjalë.



Edhe pse në emër të kontratës figuron fshati Lisockë, ky fshat nuk është i përfshirë në projekt.



Komuna kishte përcaktuar lokacionin ku do të vendosej reservuari, pa bërë paraprakisht shpronësimin e pronës.



Ka pasur vonesa në zbatim të kontratës, ku si rezultat qytetarët e Hogoshtit kanë pasur vështirësi në qarkullim nga dëmtimi i rrugëve dhe trotuareve nga dëmtimi i rrugëve dhe trotuareve dhe mos sanimi i tyre pas kryerjes së punimeve.

## REKOMANDIMET

1. Të organizohet konsultim publik me qytetarët që i ndikojnë projektet kapitale të Komunës si dhe të përfshihen rekomandimet dhe sugjerimet e tyre.

2. Të kryhen analizat e cilësisë së ujit nga burimi që pritet të merret uji dhe rezultatet e këtij testimi të ndahen me banorët e fshatit Hogosht.

3. Të shikohet mundësia e sanimit të disa prej gropave dhe dëmeve të shkaktuara nga operatori ekonomik edhe para përfundimit të kontratës. Pas përfundimit të kontratës të sanohen të gjitha gropat që kanë mbetur të hapura, të vendosen kubëzat në vendet e tyre dhe të kthehet rruga në gjendjen fillestare siç ka qenë para projektit.

DEMOS Decentralisation and Municipal Support
HELVETAS KOSOVO
platforma CIVIKOS